



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 200

23 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8426 datë 13.12.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8159
Vendim i KM nr. 1057, datë 14.12.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 500, datë 6.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar..... 8159
Vendim i KM nr.1059, datë 14.12.2013	Për emërimin në detyrë të disa anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik..... 8160
Vendim i KM nr.1060, datë 14.12.2013	Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës..... 8160
Vendim i KQZ nr. 841, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Gjirokastrë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë 8161
Vendim i KQZ nr. 842, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 8163
Vendim i KQZ nr. 843, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 8164
Vendim i KQZ nr. 844, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 8166

Vendim i KQZ nr. 845, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	8167
Vendim i KQZ nr. 846, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	8169
Vendim i KQZ nr. 847, datë 18.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	8170
Vendim i BSH nr. 82, datë 16.12.2013	Për një ndryshim në rregulloren “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare”.....	8172
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fejzo Veip Kuçuku.....	8172

DEKRET
Nr. 8426, datë 13.12.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Arsimit e Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|---|
| 1. Ali Yusuf Uyar | 8. Andreea Apetri |
| 2. Agnesa Xhevdet Hadergjonaj | 9. Diell Lulzim Bakalli |
| 3. Rasim Mustaf Zekaj | 10. Ibrahim Youssef Mohamed Abdelselam Elkhayat |
| 4. Mirushe Avdyl Zekaj (Arifaj) | 11. Edip Beşir Değer |
| 5. Antigona Kadri Podrimaj (Hoxha) | 12. Oksana Viktor Voytenko (Vojtenko) |
| 6. Selçuk Zeki Sarikaya | 13. Sylvain Joël Jean-Luc Vergnon |
| 7. Luminita Dumitru Apetri | 14. Taulant Ragip Xhaka |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 1057, datë 14.12.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 500, DATË 6.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Më pikën 1 të vendimit nr. 500, datë 6.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në numratENDORË 1 dhe 4, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

“Znj. Arjana Çela, kryetar” zëvendësohet me “z. Bujar Tollkuçi, kryetar”;

“Z. Flir Moshë, anëtar” zëvendësohet me “z. Krislen Keri, anëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 1059, datë 14.12.2013

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DISA ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË
PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 19/2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin në detyrë të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

- Z. Muharrem Çakaj;
- Z. Hektor Muçaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1060, datë 14.12.2013

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË
PUNËDHËNËSVE DHE TË PUNËMARRËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës janë, si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

- | | |
|---|-----------------------|
| a) Biznesalbania | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pijeve (SHBUP) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| dh) Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (SHSHTI) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ë) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve (DHKPV) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| f) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| g) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) | 1 anëtar, 1 kandidat. |

B. Për organizatat e punëmarrësve:

- | | |
|---|-----------------------|
| a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Federata Sindikale e Arsimit dhe Shkencës (FSASH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Sindikata Autonome e Ushqim, Tregtisë, Turizmit (SAUTT) | 1 anëtar, 1 kandidat; |

dh) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)	1 anëtar, 1 kandidat;
e) Federata e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FPISH)	1 anëtar, 1 kandidat;
ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (FSPSHSH)	1 anëtar, 1 kandidat;
f) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Artizanatit dhe Manufakturës (FSPAM)	1 anëtar, 1 kandidat;
g) Federata e Sindikatave të Shërbimeve Financiare, Tregtisë, Bankës e Turizmit	1 anëtar, 1 kandidat.

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me propozimin e organizatave përkatëse të punëmarrësve dhe punëdhënësve.

3. Vendimi nr. 132, datë 24.2.2010 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 841, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN GJIROKASTËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetar
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtar,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, në qarkun e Gjirokastrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Erjon Veliaj.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 2526/1 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, zj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Erjon Veliaj, deputet i zonës zgjedhore qarku Gjirokastrë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit



kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 26, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 3 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Gjirokastrës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Arben Ahmetaj, me numër rendor 2 (dy) Erjon Veliaj, me numër rendor 3 (tre) Anastas Angjeli.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Gjirokastrë, nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe konkretisht nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur asnjë femër në listën shumemërore. KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ “gjobë në masën 6 milionë lekë” ndaj Partisë Socialiste. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PS-së në zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar. Në listën shumemërore të PS-së në qarkun Gjirokastrë ka të përfaqësuar vetëm nga një gjini. Gjinia femërore nuk është e përfaqësuar fare.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t’i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore. Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Gjirokastrë, e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Arben Ahmetaj, me numër rendor 2 (dy) Erjon Veliaj, me numër rendor 3 (tre) Anastas Angjeli.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Gjirokastrë, kandidati, i cili renditet me numër rendor 4 (katër), është zoti Vladimir Kosta. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se personit të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Erjon Veliaj, është z. Vladimir Kosta, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 4 (katër).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 175, pika 2 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste qarku Gjirokastrë, z. Vladimir Llukan Kosta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM
Nr. 842, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi) kryetar

Hysen Osmanaj anëtar

Klement Zguri anëtar

Vera Shtjefni anëtar,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun e Fierit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Ilirjan Celibashi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7335 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Ilirjan Celibashi, deputet i zonës zgjedhore qarku Fier.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 29, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 9 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Fierit, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Gramoz Ruçi, me numër rendor 2 (dy) Erion Braçe, me numër rendor 3 (tre) Eglantina Gjermeni, me numër rendor 4 (katër) Ilirjan Celibashi, me numër rendor 5 (pesë) Armando Subashi, me numër rendor 6 (gjashtë) Arben Çuko, me numër rendor 7 (shtatë) Piro Lutaj, me numër rendor 8 (tetë) Majlinda Bufi, me numër rendor 9 (nëntë) Ervin Koçi.

Rezultun se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun e Fierit i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t’i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore qarku Fier.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për



Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore. Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Fier, e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Gramoz Ruçi, me numër rendor 2 (dy) Erion Braçe, me numër rendor 3 (tre) Eglantina Gjermani, me numër rendor 4 (katër) Ilirjan Celibashi, me numër rendor 5 (pesë) Armando Subashi, me numër rendor 6 (gjashtë) Arben Çuko, me numër rendor 7 (shtatë) Piro Lutaj, me numër rendor 8 (tetë) Majlinda Bufi, me numër rendor 9 (nëntë) Ervin Koçi.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Fier, kandidati i cili renditet me numër rendor 10 (dhjetë), është zoti Anduel Xhindi. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se personit, të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Ilirjan Celibashi, është z. Anduel Fatmir Xhindi, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 10 (dhjetë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste qarku Fier, z. Anduel Fatmir Xhindi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 843, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi) kryetar

Hysen Osmanaj anëtar

Klement Zguri anëtar

Vera Shtjefni anëtar,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun e Tiranës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Milena Harito.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7336 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Milena Harito, deputete e zonës zgjedhore qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicionëve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 16 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Tiranës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Pandeli Majko, me numër rendor 2 (dy) Saimir Tahiri, me numër rendor 3 (tre) Vasilika Hysi, me numër rendor 4 (katër) Ditmir Bushati, me numër rendor 5 (pesë) Fatmir Xhafaj, me numër rendor 6 (gjashtë) Lindita Nikolla, me numër rendor 7 (shtatë) Besnik Baraj, me numër rendor 8 (tetë) Xhemal Qefalia, me numër rendor 9 (nëntë) Sadri Abazi, me numër rendor 10 (dhjetë) Parid Cara, me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) Spartak Braho, me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) Artan Gaçi, me numër rendor 13 (trembëdhjetë) Pjerin Ndreu, me numër rendor 14 (katërmëdhjetë) Rakip Suli, me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë) Milena Harito, me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë) Dashamir Peza.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Tiranë nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur 30% nga secila gjini në listën shumemërore. KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ “gjobë në masën 6 milionë lekë” ndaj Partisë Socialiste. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakante, të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PS-së në zonën zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore.

Sipas dispozitave të sipërcituara, në çdo rast, rezulton se vakanca e krijuar nga heqja dorë nga mandati i deputetes i znj. Milena Harito, do të zëvendësohet nga kandidatja e parë e gjinisë më pak të përfaqësuar, e cila renditet pas znj. Milena Harito në listën shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Tiranë.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të depozituar nga PS-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Tiranë, rezulton se kandidatja e radhës sipas deklaramit është kandidatja me nr. rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) znj. Enkelejda Hamit Shkreli.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) znj. Enkelejda Hamit Shkreli, të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore qarku Tiranë.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 175, pika 2 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, qarku Tiranë, znj. Enkelejda Hamit Shkreli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 844, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi) kryetar

Hysen Osmanaj anëtar

Klement Zguri anëtar

Vera Shtjefni anëtar,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, në qarkun e Fierit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Eglantina Gjermani.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7337 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Eglantina Gjermani, deputete e zonës zgjedhore qarku Fier.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 29, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 9 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Fierit, janë si 8166

më poshtë: me numër rendor 1 (një) Gramoz Ruçi, me numër rendor 2 (dy) Erion Braçe, me numër rendor 3 (tre) Eglantina Gjermeni, me numër rendor 4 (katër) Ilirjan Celibashi, me numër rendor 5 (pesë) Armando Subashi, me numër rendor 6 (gjashtë) Arben Çuko, me numër rendor 7 (shtatë) Piro Lutaj, me numër rendor 8 (tetë) Majlinda Bufi, me numër rendor 9 (nëntë) Ervin Koçi.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Fier i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës, mandati i perkiste kandidates znj. Eglantina Gjermeni, e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas zonjës Eglantina Gjermeni, që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të depozituar nga PS-ja, në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore, qarku Fier, rezultoni se kandidatja e radhës sipas deklaramentit është kandidatja me nr. rendor 14 (katërbëdhjetë), znj. Adelina Petraq Rista.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 14 (katërbëdhjetë), znj. Adelina Petraq Rista, të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore qarku Fier.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste qarku Fier, znj. Adelina Petraq Rista.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 845, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi) kryetar
Hysen Osmanaj anëtar



Klement Zguri anëtar
Vera Shtjefni anëtar,
shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Tiranës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetes të znj. Klajda Gjoshja.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7338 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Klajda Gjoshja, deputete e zonës zgjedhore qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 3 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun e Tiranës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Ilir Meta, me numër rendor 2 (dy) Klajda Gjoshja, me numër rendor 3 (tre) Luan Rama.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Tiranë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, përpara krijimit të vakancës mandati i përkiste kandidatës Klajda Gjoshja, e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte, në plotësimin e vakancës KQZ-ja do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas zonjës Klajda Gjoshja, që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të depozituar nga LSI-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Tiranë, rezultoni se kandidatja e radhës sipas deklaramit është kandidatja me nr. rendor 7 (shtatë) znj. Kejdi Fatmir Mehmetaj.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatës me numër rendor 7 (shtatë) znj. Kejdi Fatmir Mehmetaj të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim qarku Tiranë, znj. Kejdi Fatmir Mehmetaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 846, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN BERAT, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetar
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtar,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Beratit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Nasip Naço.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a” dhe neni 175, pika 2 e ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7339 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Nasip Naço, deputeti i zonës zgjedhore qarku Berat.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 33, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Berat, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për



Integrim, për zonën zgjedhore qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun e Beratit, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Nasip Naço, me numër rendor 2 (dy) Gledjon Rehovica.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun e Beratit, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor dhe, konkretisht, nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013, vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 4 milionë lekë ndaj Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e LSI-së, në zonën zgjedhore qarku Berat, duhet të zbatohet dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore, në listën shumemërore të LSI-së në qarkun Berat, kandidatja e renditur e para nga gjinia më pak e përfaqësuar, është kandidatja me numër rendor 4 (katër) znj. Silva Maksim Caka.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 175, pika 2 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim qarku Berat, znj. Silva Maksim Caka.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 847, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi) kryetar

Hysen Osmanaj anëtar

Klement Zguri anëtar

Vera Shtjefni anëtar,

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Elbasanit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Edmond Haxhinasto.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7340 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Edmond Haxhinasto, deputet i zonës zgjedhore qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 30, datë 2.8.2013 “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Elbasan, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun e Elbasanit, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Edmond Haxhinasto, me numër rendor 2 (dy) Bujar Kllogjri.

Rezultoni se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste për Integrim në qarkun Elbasan i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Elbasan.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore. Sipas vendimit të mësipërm, lista shumëmemërore e Partisë Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan, e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Edmond Haxhinasto, me numër rendor 2 (dy) Bujar Kllogjri.

Sipas listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan, kandidati i cili renditet me numër rendor 3 (tre), është zonja Miranda Rexhep Rira. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezultoni se personit, të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumëmemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Edmond Haxhinasto, është znj. Miranda Rexhep Rira, e cila renditet përkatësisht me numër rendor 3 (tre).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim qarku Elbasan, znj. Miranda Rexhep Rira.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 82, datë 16.12.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR KONTROLLIN PËR AUTENTICITET
DHE KRITERET E RICIKLIMIT TË KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” nenit 43, shkronja “c” dhe kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në rregulloren “Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare”, miratuar me vendimin nr. 15, datë 13.2.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

1.1 Në nenin 25, pika 2, togfjalëshi “jo më vonë se 9 muaj”, zëvendësohet me togfjalëshin “jo më vonë se 12 muaj”.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikën në Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 2718, datë 26.11.2013, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Fejzo Veip Kuçuku, i datëlindjes 5.4.1926 dhe caktimin si kujdestare të përhershme për administrimin e pasurisë së tij shtetasen Vildane Kuçuku.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 20 lekë